



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 301/4 Prot.

Vlorë më 28.02.2025

VENDIM

Nr. 14, datë 28.02.2025

**PËR
NGARKIMIN ME DETYRËN E ADMINISTRATORIT TË KOMANDUAR
TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË, DERI NË PËRFUNDIM TË
PROCEDURËS SË PUNËSIMIT**

Në mbështetje të nenit 49, 51 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, pika 1, gërma g të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 "Për Strukturat e Brendshme Akademike dhe Administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", të MAS, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 28.02.2025,

VENDOSI:

1. Për të lejuar vijimin normal të punës në institucion, deri në përfundim të procedurës të punësimit për këtë pozicion pune, referuar viteve të punës në UV dhe viteve në fushën e financës, Bordi i Administrimit, vendosi të ngarkojë me detyrën e "Administratorit" të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë Znj. Ingrid Karalli.
2. Znj. Ingrid Karalli do të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për këtë funksion në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore të UV-së.
3. Ky emërim do të mbetet në fuqi deri në një vendim të mëtejshëm për emërimin e administratorit të përhershëm sipas procedurave ligjore dhe statutore.
4. Komunikimi i këtij vendimi i bëhet me dije Rektores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Senatit Akademik, Drejtuesve të Njësisve Kryesore, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Degës së Thesarit Vlorë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të gjitha strukturave përbërëse të UV-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

SOTIR NIKOLLA

Adresa /Adress: Bulevardi Vlorë – Skelë
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

